



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 29.12.2016

PËR

NDRYSHIMIN E DYTË NË PLANIN KOMBËTAR SEKTORIAL  
PËR PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)

Në mbështetje të neneve 5, 7, 17 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të pikës 27.1, të nenit 27 dhe të pikës 6/1/b, nënndarja “iii”, e pjesës 1, të shtojcës 1, të Ligjit 116/2013, datë 15.04.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 62, datë 27.01.2016 “Për miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për ndryshimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1097, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të dytë në Planin Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, përfshirë hartën përmbledhëse të këtij vendimi.
2. Pikat 2, 3, 4 dhe 5 të Vendimit Nr. 1, datë 04.07.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, ruajnë të njëjtën vlefshmëri edhe sipas këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**



**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOHA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

